

e bartur



REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA E KOSOVES
 SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
 ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
 Prishtinë - Pristina

05/1851/10-970

Date: 30.03.2016
 Division: PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Kuvendi – Skupština – Assembly

PËR / ZA / TO	z. Kujtim Shala Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit	DATE DATUM DATE	30/03/2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Abdyl Ymeri, Deputet		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA:

Qe të kemi një shoqëri të formuar dhe të ngritur denjësisht, patjetër se duhet të kemi një rini të shëndosh.

Rinia jonë sot ka më shumë nevojë për sport e kulturë, se sa ta tretin kohën e çmuare nëpër kafiteri, prandaj institucionet tona kanë për obligim që të ju krijojnë kushte dhe hapësira për zhvillim normal të aktiviteteve sportive dhe kulturore.


Pasi qe sporti na mundëson të kemi një trup të shëndetshëm, ndërsa kultura na mundëson qe shpirti ynë të jetë i mbushur me lumturi e dashuri.

Ne disa komuna ka ca vite qe ka filluar ndërtimi i palestrave sportive, me qëllim të krijimit të hapësirave të mjaftueshme për zhvillim normal të aktiviteteve sportive . Ne komunën e Skenderajt një projekti i tille ka filluar ne vitin 2009, por qe ende nuk ka përfunduar. Edhe këtë vit është ndarë një shumë e mjeteve për të vazhduar këtë projekte, mirëpo nuk mjaftojnë për përfundimin e kësaj palestere.


PYETJE PARLAMENTARE:

z. Ministër, kur pritet qe të përfundoj kjo palestër, ne mënyrë qe klubet sportive të kësaj komune, t'i zhvillojnë ushtrimet dhe garat në ambientet e kësaj palestër.

e burtur



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa	DATE DATUM DATE	10.5.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Raif Qela, deputet 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45, pika 2. e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Nëse e drejta në pronë është një e drejtë universale, e sanksionuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 46, ku thuhet se e drejta e pronës është e garantuar, pse institucionet e Kosovës nuk kanë ndërmarrë dhe nuk po ndërmarrin asgjë serioze, në mënyrë që qytetarëve shqiptarë të dëbuar me dhunë nga pronat e veta në pjesën veriore të Mitrovicës t'iu lejohet kthimi në pronat e veta dhe t'iu krijohet siguri për banim e jetë të rehatshme?

e bartur



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KOSOVO
KUVENDI / REPUBLIKË / SKUPŠTINA
ASSEMBLY OF KOSOVO

MI Post
Prot. No. 05/2013/10-1040

16.05.2016

ORIENTIM: PRISTINA - PRISTINA

PËR/ZA/TO	Ministrin e Shëndetësisë z.Imet Rrahmani	DATE DATUM DATE	16.05.2016
NGA/OD/FROM	Deputetja Blerta Deliu Kodra <i>Blerta Deliu Kodra</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

I nderuari z.Ministër

Janë bërë disa vite prej se ka filluar mamografi mobil, deri më tani është shtri në 17 komuna..

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Ka 6 muaj që disa punëtor nuk janë paguar përkundër punës së mirë që po e bëjnë në teren... Cka do të bëj ministria për të rregulluar këtë problematik?